



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 1/2024 Regjistri (JR)  
Datë 09.01.2024

Nr. 21 i vendimit  
Datë 13.05.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 13.05.2024, ditën e hënë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 1/2024 (JR), datë 09.01.2024, që i përket:

**ANKUES:**

Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:**

1. Prishja e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Urdhërimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë të kryejë procedurat administrative në kuadër të procesit të rivlerësimit për kërkuesin, z. Besnik Maho, ish-gjyqtar.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**ANKUES:**

Besnik Maho

**OBJEKTI:**

1. Shfuqizimi i vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të shumicës së anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i dhënë në kundërshtim me një proces të rregullt ligjor.

2. Dhënia e së drejtës kushtetuese dhe ligjore për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe ish-magjistratët që kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit për më shumë se 3 vjet.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi prishjen e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, (në vijim Komisioni), shqyrtoi pretendimet e paraqitura në ankim dhe në parashtrime nga ankuesi Besnik Maho, i cili përfundimisht kërkoi shfuqizimin e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Ankuesi Besnik Maho, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka shprehur vullnetin për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtar, nëpërmjet kërkesës me shkrim, sipas neneve 31, pika 3, 35, pika 3 dhe 41, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, pasi në periudhën 2005-2008 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, si dhe funksionin e drejtuesit në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Komisioni në datën 13.01.2021, nëpërmjet postës elektronike, ka njoftuar ankuesin për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues, si dhe i ka kërkuar informacion shtesë sipas pyetësorit standard. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, në datën 17.10.2023, ka njoftuar ankuesin mbi: (i) rezultatet e hetimit për kërkesën për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar; (ii) dhënien e shpjegimeve dhe/ose paraqitjen e provave, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe sjelljen e provave për të provuar të kundërtën jo më vonë

se data 20.10.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Ankuesi Besnik Maho ka paraqitur në datën 24.10.2023 pretendimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit mbi plotësimin e kriterëve për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, duke kundërshtuar konstatimin e Komisionit se nuk plotëson afatin e ushtrimit të detyrës si gjyqtar për të paktën 3 vjet. Në vazhdim të njoftimit nga Komisioni për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 13.11.2023, ankuesi ka kundërshtuar zhvillimin e kësaj seance, pa u zhvilluar më parë një hetim i rregullt administrativ, njësoj si magjistratët e tjerë, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 42 të Kushtetutës.
4. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, sipas përkufizimit të parashikuar në pikën 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është në rrethin e personave të përfshirë në pikën 4, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës, duke qenë se nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk ka punuar të paktën 3 vjet në pozicionin e gjyqtarit. Bazuar në këtë konkluzion, Komisioni, me vendimin nr. 714, datë 15.11.2023, vendosi të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar për kërkuesin Besnik Maho.
5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, bazuar në nenet C, pika 2 dhe F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.12.2023, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit, pasi nga shqyrtimi i këtij vendimi ka çmuar se përmban shkaqe ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
6. Ankuesi Besnik Maho, në datën 22.12.2023, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit, duke pretenduar se ky vendim është haptazi i padrejtë, pasi është marrë në mungesë të analizës së provave dhe të ligjit dhe në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

## **II. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

7. Komisioneri Publik, në mënyrë të përmbledhur në ankim, parashtron se në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, konstaton se z. Besnik Maho, për sa i takon kriterit të vjetërsisë në pozicionin e gjyqtarit, e plotëson kushtin për t'u konsideruar subjekt rivlerësimi nga radhët e ish-gjyqtarëve. Referuar fakteve dhe rrethanave juridike, lidhur me përcaktimin e vjetërsisë në detyrën e gjyqtarit për z. Besnik Maho, në vlerësim të dispozitave ligjore në fuqi, për efekt të procesit të rivlerësimit, përlllogaritja e vjetërsisë në rastin konkret duhet të fillojë nga data 17.09.2004, kur subjekti i rivlerësimit është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional, e deri në datën 21.05.2008 (duke e përmbushur kriterin kohor prej tri vitesh), kur ai është shkarkuar nga detyra dhe nuk ka qenë më në shërbim si pjesë e institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

8. Në përfundim, Komisioneri Publik, duke vlerësuar se përfundimi i arritur nga shumica në Komision nuk gjen mbështetje në faktet dhe parashikimet ligjore, i kërkoi Kolegjit që në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë: - *Prishjen e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. - Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë të kryejë procedurat administrative në kuadër të procesit të rivlerësimit për kërkuesin, z. Besnik Maho, ish-gjyqtar.*

### **III. Shkaqet e ankimit të ankuesit Besnik Maho**

9. Ankuesi Besnik Maho, në ankimin drejtuar Kolegjit, ka kërkuar në mënyrë të përmblodhur:

- *Për procesin e zhvilluar në Komision*

9.1. Komisioni, në rastin e ankuesit, ka zhvilluar një proces të parregullt hetimor administrativ në aspektin e kontradiktoritetit dhe mbrojtjes, pasi për një periudhë prej 2 viteve e pesë muaj pas dorëzimit të pyetësorit standard nuk i ka kthyer përgjigje kërkesave të ankuesit për informacion, si dhe nuk i është dhënë mundësia e zhvillimit të pyetje-përgjigjeve në bazë të pyetësorëve, si gjithë magjistratët e tjerë të rivlerësuar.

9.2. Koha e lënë në dispozicion ankuesit, për të prapësuar gjetjet e rezultateve të hetimit, ka qenë shumë e shkurtër, vetëm 4 ditë.

9.3. Pasi është njohur me mendimin e pakicës, pas daljes së vendimit përfundimtar, ankuesi ka konstatuar se Komisioni ka administruar aktin Raport i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, (në vijim “KLD”), nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2013, ku janë pasqyruar të dhëna dhe fakte për të cilat ai nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar, si gjatë procesit të hetimit, ashtu dhe në rezultatet e hetimit, si dhe ky fakt dhe të dhënat e këtij raporti mungojnë, si në raportin e rezultateve të hetimit, ashtu dhe në vendimin përfundimtar të shumicës.

- *Për aspektin përmbajtësor të gjetjeve të Komisionit*

9.4. Ankuesi kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur mbi tre vjet punë si gjyqtar, pasi referuar ligjit të kohës nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, viti i tretë i Shkollës së Magjistraturës përbën një marrëdhënie specifike pune, gjatë së cilës kandidati për magjistrat ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore njësoj si magjistratët e emëruar në detyrë. Ndërsa, për periudhën e emërimit në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë ankuesi parashtron se periudha e shërbimit në drejtim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, (në vijim AKKP), duhet të njihet si periudhë vjetërsie si gjyqtar, sipas ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, (në vijim “ligji nr. 8678/2001”). Për rrjedhojë, periudha e punës në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, periudha e punës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Pogradec, si dhe emërimi si funksionar i lartë në AKKP, strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, përbëjnë së bashku periudhën e mjaftueshme mbi tre vite punë si gjyqtar.

10. Në përfundim, ankuesi Besnik Maho, duke pretenduar se procesi i rivlerësimit ndaj tij duhej përfunduar me vendim përfundimtar për të tria kriteret, i kërkoi Kolegjit shfuqizimin e

vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit dhe dhënien e të drejtës kushtetuese dhe ligjore për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar.

11. Bashkë me ankimin, ankuesi ka paraqitur në Kolegj aktet: (i) dokumentin "Sqarim" i datës 24.10.2023, drejtuar Komisionit; (ii) kopje e librezës së punës; (iii) vërtetim vjetërsie në punë, nr. {\*\*\*} prot., datë 24.10.2015, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë; (iv) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 06.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan; (v) vendim nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2007, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë; (vi) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2021, i Filialit të Postës Shqiptare Tiranë; (vii) prokurë e posaçme e datës 20.10.2016, origjinal, në anglisht dhe shqip. Ndërsa, me parashtrimet e paraqitura me postë elektronike, regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*}, datë 07.05.2024, ankuesi ka paraqitur dhe aktin: *procesverbal inventarizimi i dorëzimit të dokumentacionit në ish-KLD, datë 08.11.2016.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

###### *a) Mbi juridiksionin e Kolegjit*

12. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *b) Mbi legjitimitimin e ankuesve*

13. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
14. Ankuesi Besnik Maho, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka paraqitur kërkesë si ish-gjyqtar për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit, dhe legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
15. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për ankuesin është shpallur në seancë publike më datë 15.11.2023. Vendimi nr. 714, datë 15.11.2023, i arsyetuar, i është njoftuar ankuesit, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2023, të Komisionit, për të cilën ankuesi ka marrë dijeni më datë 16.12.2023 dhe ankimin e ka paraqitur në datën 22.12.2023. Ndërsa Komisioneri Publik

rezulton se ka marrë njoftim për vendimin e Komisionit në datën 12.12.2023 dhe ankimin e ka paraqitur në datën 27.12.2023. Për rrjedhojë, rezulton se të dy ankimet janë paraqitur brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe të dy ankuesit legjitimohen *ratione temporis*.

c) *Mbi formën e gjykimit të ankimit*

16. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për shkak se një nga ankuesit është Komisioneri Publik, u shqyrtua nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike. Në kushtet kur ndaj vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit, kanë ushtruar ankim njëkohësisht Komisioneri Publik dhe ankuesi Besnik Maho, trupi gjykues, në përputhje me dispozitat e neneve 448 dhe 461 të Kodit të Procedurës Civile, vijoi gjykimin e të dy ankimeve në një proces të vetëm.
17. Ankuesi Besnik Maho nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 16.04.2024, duke njoftuar Kolegjin me *e-mail*, në datën 12.04.2024, se e kishte të pamundur që të merrte pjesë në seancë, për shkak se për arsye familjare ndodhej jashtë shtetit. Trupi gjykues vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore në datën 07.05.2024, me qëllim që t'i jepej mundësi ankuesit të ishte prezent në gjykimin e çështjes. Në datën 06.05.2024, ankuesi ka paraqitur me *e-mail* parashtrimet e tij duke njoftuar Kolegjin se sërish për arsye objektive, që lidhen me edukimin e fëmijëve të tij, e kishte të pamundur që të ishte i pranishëm në seancën dëgjimore të datës 07.05.2024. Ankuesi sërish nuk u paraqit as në seancat e datave 10.05.2023 dhe 13.05.2024, megjithëse kishte dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të tyre. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në nenin 34, pika 2<sup>1</sup> e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vijoi gjykimin e çështjes pa praninë e ankuesit.
18. Trupi gjykues, bazuar në nenin 47<sup>2</sup> të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, si dhe nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e paraqitura nga ankuesi, bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve. Trupi gjykues konstatoi se disa prej akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ishin akte të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe, për këto arsye, vendosi të mos i marrë si prova, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016<sup>3</sup>. Ndërsa aktet e tjera<sup>4</sup> të paraqitura nga ankuesi nuk u pranuan si prova nga trupi gjykues, pasi nuk plotësonin kërkesat e nenit 251 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak se ishin kopje të pavërtetuara nga autoriteti kompetent.

---

<sup>1</sup> Mosparaqitja e palëve në seancë nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit.

<sup>2</sup> “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

<sup>3</sup> Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

<sup>4</sup> Kopje e librezës së punës; vërtetim vjetërsie në punë, nr. {\*\*\*} prot., datë 24.10.2015, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë; vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 06.10.2016, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan.

## **B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji**

### **B/1. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt**

19. Ankuesi Besnik Maho parashtron se Komisioni ka zhvilluar një proces të parregullt hetimor administrativ në aspektin e kontradiktoritetit dhe mbrojtjes, pasi për një periudhë prej 2 vitesh e pesë muaj pas dorëzimit të pyetësorit standard, nuk u ka kthyer përgjigje kërkesave të ankuesit për informacion, si dhe nuk i është dhënë mundësia e zhvillimit të pyetje-përgjigjeve në bazë të pyetësorëve, si gjithë magjistratët e tjerë të rivlerësuar.
20. Lidhur me sa parashtron ankuesi, trupi gjykues konstaton nga aktet se Komisioni i ka dërguar ankuesit pyetësorin standard me *e-mail* në datën 13.01.2021. Në datën 28.01.2021 ankuesi ka njoftuar me *e-mail* Komisionin për tërheqje nga procesi i rivlerësimit, pasi me vendimin e datës 25.01.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ishte shpallur fitues për pozicionin e inspektorit pranë këtij institucioni. Në datën 30.04.2021, Komisioni i ka dërguar një *e-mail* ankuesit, ku i kërkon që të paraqesë një kërkesë me shkrim për tërheqjen e tij nga procesi i rivlerësimit kalimtar. Ankuesi, me *e-mail*, në datën 06.05.2021, i ka kërkuar Komisionit ndryshimin e kërkesës së mëparshme për t'u tërhequr nga procesi i rivlerësimit dhe vazhdimin e këtij procesi si ish-magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec.
21. Nga sa rezulton më sipër, konstatohet se për periudhën 28 janar - 6 maj 2021 Komisioni ka ndërprerë hetimin administrativ për ankuesin, sipas kërkesës së këtij të fundit për tërheqje nga procesi i rivlerësimit kalimtar dhe vetëm pas *e-mail*-it të tij për ndryshim kërkesë ka vazhduar me hetimin. Ndërkohë që, për periudhën tjetër deri në dërgimin rezultateve të hetimit në datën 17.10.2023, rezulton se Komisioni, në kuadër të hetimit lidhur me statusin e ankuesit, ka pasur komunikim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, (në vijim "KLGj"), duke kërkuar informacion lidhur me statusin si gjyqtar, si dhe dokumentacionin që disponohej nga ky institucion për ankuesin.
22. Trupi gjykues konstaton se të njëjtin pretendim se nuk i është dhënë mundësia me pyetje-përgjigje, në bazë të pyetësorëve të nevojshëm si gjithë magjistratët e tjerë të rivlerësuar, ankuesi e ka paraqitur dhe në Komision, i cili në vendim është shprehur se: *Referuar parashikimeve të mësipërme ligjore, Komisioni, në kuadër të verifikimit të kriterëve të parashikuara nga neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ka administruar dokumentacionin e nevojshëm nga KLGj-ja për vërtetimin e fakteve që kanë lidhje me kohën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit nga kërkuesi. Në vijim, me anë të postës elektronike, kërkuesi është njoftuar lidhur me problematikat që janë hasur gjatë hetimit administrativ, për sa i përket dokumentacionit të paraqitur prej tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, si dhe ka administruar provat e paraqitura nga kërkuesi përmes postës elektronike. Më pas, Komisioni, në datën 17.10.2023, përmes postës elektronike ka njoftuar kërkuesin lidhur me rezultatet e hetimit dhe me të drejtën për t'iu njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë që t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar e, për pasojë, fillimisht ka hetuar nëse z. Besnik Maho plotëson në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar dhe, nëse*

*do të rezultonte se i plotëson këto kritere, do të vijohej me përfshirjen në procesin e rivlerësimit<sup>5</sup>.*

23. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se, pavarësisht sa pretendon ankuesi, nuk mund të konkludohet për shkelje të procesit të rregullt nga Komisioni, për shkak të zgjatjes dhe mënyrës së kryerjes së hetimit administrativ, pasi, për shkak të specifikës së rastit të ankuesit, Komisioni nuk mund të kryente procedurën e dërgimit të pyetësorëve si subjektet e tjerë të rivlerësimit kalimtar, për sa kohë që nuk ishte konkluduar nëse ai kishte ose jo statusin e subjektit të rivlerësimit.
24. Ankuesi pretendon në ankim se koha e lënë në dispozicion për të prapësuar gjetjet e rezultateve të hetimit ka qenë shumë e shkurtër, vetëm 4 ditë. Këtë pretendim ankuesi e ka ngritur dhe në Komision, i cili në vendim është shprehur se: *Lidhur me pretendimin se koha që të bëjë sqarime apo prapësime me gjetjet e konstatuara, për 4 ditë, është një kohë tërësisht e pamjaftueshme për një mbrojtje efektive, Komisioni arsyeton se në relacionin e rezultateve të hetimit është arritur në përfundimin se z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, pasi nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara nga pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës: (i) të ketë punuar gjyqtar; (ii) të ketë punuar të paktën 3 vite në këtë pozicion, në këto kushte, duke vlerësuar kompleksitetin e çështjes, kërkuesit i është kërkuar të paraqesë shpjegimet e tij me shkrim brenda 3 ditëve. Megjithatë, pavarësisht se kërkuesi i paraqiti shpjegimet e tij përtej afatit të përcaktuar nga Komisioni, ato u administruan dhe u vlerësuan, duke mos cenuar të drejtën e tij për një mbrojtje efektive<sup>6</sup>.*
25. Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, trupi gjykues konstaton se pavarësisht se Komisioni ka caktuar një afat 4-ditor për të paraqitur prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, në përfundim i ka pranuar prapësimet e ankuesit edhe pas datës së caktuar si afat, duke mos cenuar të drejtën e tij për t'u mbrojtur, kështu që ky pretendim i ankuesit nuk qëndron.
26. Ankuesi parashtron në ankim se vetëm pasi është njohur me mendimin e pakicës, pas daljes së vendimit përfundimtar, ka konstatuar se Komisioni ka administruar aktin *Raport i KLD-së nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2013*, në të cilin janë pasqyruar të dhëna dhe fakte për të cilat ai nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar, si gjatë procesit të hetimit, ashtu edhe në rezultatet e hetimit, dhe ky fakt, me të dhënat e këtij raporti mungojnë si në raportin e rezultateve të hetimit, ashtu dhe në vendimin përfundimtar të shumicës.
27. Për sa pretendon ankuesi, trupi gjykues vëren nga aktet se Komisioni i është drejtuar KLGj-së, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 13.06.2023, me kërkesë për dhënien e informacionit lidhur me statusin si gjyqtar të shtetasit Besnik Maho, si dhe ka administruar aktet e përcjella nga KLGj-ja, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 21.06.2023: (i) kërkesë nr. {\*\*\*}, datë 13.09.2013, e z. Besnik Maho, për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) raport i Komisionit të Shqyrtimit të Kandidaturave për gjyqtarë në KLD, nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2013; (iii) procesverbal i mbledhjes plenare të KLD-së, datë 16.12.2013.

---

<sup>5</sup> Paragrafi 47 i vendimit të Komisionit.

<sup>6</sup> Paragrafi 49 i vendimit të Komisionit.



28. Në raportin e rezultateve të hetimit, dërguar ankuesit nga Komisioni me e-mail në datën 17.10.2023, në pikën 14, citohet se [...] KLGj-ja ka përcjellë pranë Komisionit kërkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.09.2013, të z. Maho për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2013, të KLD-së “Mbi rezultatet e pikëzimit të kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor” dhe procesverbalin e mbledhjes plenare të ish-KLD-së të datës 16.12.2013. Në vazhdim, në pikën 16 të raportit të rezultateve të hetimit citohet se [...] në raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2013, të KLD-së “Mbi rezultatet e pikëzimit të kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor”, rezulton se z. Besnik Maho figuron në renditje i pari në listën e kandidatëve “jo gjyqtarë magjistratë”. KLGj-ja ka përcjellë procesverbalin e mbledhjes së datës 16.12.2013 dhe nuk rezulton që ky organ të ketë marrë në shqyrtim kërkesën e z. Maho për t’u rikthyer si gjyqtar.
29. Komisioni në vendim referon se në kuadër të verifikimit të kritereve të parashikuara nga neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës, ka administruar dokumentacionin e nevojshëm nga KLGj-ja për vërtetimin e fakteve që kanë lidhje me kohën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit nga kërkuesi. Në vijim, me anë të postës elektronike, kërkuesi është njoftuar lidhur me problematikat që janë hasur gjatë hetimit administrativ, për sa i përket dokumentacionit të paraqitur prej tij për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, si dhe ka administruar provat e paraqitura nga kërkuesi përmes postës elektronike. Më pas, Komisioni, në datën 17.10.2023, përmes postës elektronike ka njoftuar kërkuenin lidhur me rezultatet e hetimit dhe me të drejtën për t’u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit.
30. Nga aktet e mësipërme, trupi gjykues vëren se Komisioni, në raportin e rezultateve të hetimit, ka cituar dokumentacionin që ka administruar nga KLGj-ja, midis të cilit përmendet dhe raporti në fjalë, si dhe jepen dhe të dhëna për përmbajtjen e këtij raporti. Ndërkohë, rezulton se ankuesi ka marrë dijeni për përmbajtjen e raportit mbi rezultatet e hetimit, fakt që provohet nga sqarimet që ka dërguar në Komision, në datën 24.10.2023, ku ai shprehet se në lidhje me përmbajtjen e këtij relacioni më lejoni të jap qëndrimin tim në aspektin procedural dhe material. Komisioni, në e-mail-in e datës 17.10.2023, me të cilin ka dërguar rezultatet e hetimit, e ka njoftuar ankuesin dhe për të drejtën për t’u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se nëse ankuesi do të kishte shfrytëzuar këtë të drejtë<sup>7</sup>, ai do të kishte pasur mundësinë të njihej me raportin e KLD-së, si dhe të bazonte prapësimet e tij në të dhënat e këtij raporti, që, sipas pretendimit të tij, kanë qenë në favor të tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e ankuesit se nuk është njohur me të dhënat e raportit të KLD-së, si në raportin e rezultateve të hetimit, ashtu edhe në vendimin përfundimtar të shumicës dhe se ka marrë dijeni për këtë akt vetëm nga mendimi i pakicës.

## **B/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vendimin e Komisionit**

31. Sipas Komisionerit Publik, në analizë të akteve në dosje, të rezultateve të hetimit, të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit, konstatohet se z.

<sup>7</sup> Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton dhe se ankuesi nuk ka marrë pjesë në seancat publike të zhvilluara në Komision, megjithëse është njoftuar dhe ka pasur dijeni për datën dhe orën e seancave, siç rezulton nga korrespondenca me e-mail me Komisionin, në datat 01.11.2023 dhe 10.11.2023, ku ai kundërshton zhvillimin e seancës dëgjimore pa u zhvilluar më parë një hetim administrativ si gjithë magjistratët e tjerë.

Besnik Maho, për sa i takon kriterit të vjetërsisë në pozicionin e gjyqtarit, plotëson kushtin për t'u konsideruar subjekt rivlerësimi nga radhët e ish-gjyqtarëve. Referuar fakteve dhe rrethanave juridike, lidhur me përcaktimin e vjetërsisë në detyrën e gjyqtarit për z. Besnik Maho, në vlerësim të dispozitave ligjore në fuqi, për efekt të procesit të rivlerësimit, përlllogaritja e vjetërsisë në rastin konkret duhet të fillojë nga data 17.09.2004, kur subjekti i rivlerësimit është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional, e deri në datën 21.05.2008, (duke e përmbushur kriterin kohor prej tri vitesh), kur ai është shkarkuar nga detyra dhe nuk ka qenë më në shërbim si pjesë e institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

32. Ankuesi Besnik Maho kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka pasur mbi tre vjet punë si gjyqtar, pasi referuar ligjit të kohës nr. 8136, datë 31.07.1996, "Për Shkollën e Magjistraturës", i ndryshuar, viti i tretë i shkollës së Magjistraturës përbën një marrëdhënie specifike pune, gjatë së cilës kandidati për magjistrat ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore njëjloj si magjistratët e emëruar në detyrë. Ndërsa për periudhën e emërimit në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, ankuesi parashtron se periudha e shërbimit në drejtim të AKKP-së duhet të njihet si periudhë vjetërsie si gjyqtar, sipas ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë". Për rrjedhojë, periudha e punës në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, periudha e punës si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Pogradec, si dhe emërimi si funksionar i lartë në AKKP, strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, përbëjnë së bashku periudhën e mjaftueshme mbi tre vite punë si gjyqtar.
33. Nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe ankuesit Besnik Maho, trupi gjykues vëren se ankuesit kundërshtojnë konkluzionin e Komisionit që z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, pasi nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara në pikën 4, të nenit 179/b të Kushtetutës, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak se nuk ka ushtruar për të paktën 3 vjet funksionin e gjyqtarit. Meqenëse shkaqet e ankimit janë të njëjta në këtë drejtim, trupi gjykues, në vijim, i shqyrton dhe analizon ato së bashku.
34. Nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se:
- 34.1. Ankuesi Besnik Maho ka kryer studimet dhe është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002-2005.
- 34.2. Me Dekretin nr. 4326, datë 17.9.2004, të Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 20/a<sup>8</sup> të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (në vijim "ligji nr. 8436/1998"), Besnik Maho është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- 34.3. Me Dekretin nr. 4655, datë 3.10.2005, të Presidentit të Republikës, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

---

<sup>8</sup> "1. Me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Presidenti i Republikës emëron gjyqtarë personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës për të kryer stazhin profesional, të parashikuar në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996, "Për shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë", në gjykatat që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi. [...] 3. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekretin caktimin e tyre në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas nevojave që ato kanë".

34.4. Në datën 13.6.2007, z. Besnik Maho ka paraqitur pranë ish-KLD-së kërkesën për t'u dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit dhe miratimin e kërkesës për t'u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

34.5. Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2007, ka kërkuar nga KLD-ja dhënien e pëlqimit për kalimin e z. Besnik Maho me detyrë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

34.6. KLD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.6.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

34.7. Me VKM-në nr. 392, datë 28.6.2007, "Për lirim dhe emërim në detyrë", z. Besnik Maho është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i AKKP-së. Më pas, me VKM-në nr. 627, datë 21.5.2008, z. Besnik Maho është shkarkuar nga kjo detyrë.

34.8. Në datën 13.09.2013 z. Besnik Maho i është drejtuar KLD-së me kërkesë për t'u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8678/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", sipas të cilit i lindte e drejta të kërkonte rikthimin në sistemin gjyqësor.

34.9. Ankuesi Besnik Maho, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka kërkuar që si ish-gjyqtar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për të tri kriteret e rivlerësimit, duke plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional, dorëzuar pranë ish-KLD-së, në datë 08.11.2016, dhe atë të kontrollit të figurës, dorëzuar pranë ish-DSIK-së. Për sa i përket dorëzimit të deklaratës së pasurisë, ankuesi ka sqaruar në Komision se deklarata, së bashku me dokumentacionin shoqërues nuk është pranuar nga ILDKPKI-ja të dorëzohej nga bashkëshortja e tij në zyrën e protokollit të këtij institucioni, për arsye se ai nuk ishte në atë kohë pjesë e sistemit të organeve të drejtësisë, dhe është dërguar me postë në drejtim të ILDKPKI-së.<sup>9</sup>

35. Komisioni, pas përfundimit të hetimit administrativ, në vendimin objekt shqyrtimi ka arritur në konkluzionin se z. Besnik Maho nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret për t'iu nënshtuar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, për shkak të mosplotësimit të kriterit kushtetues, të vendosur nga pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës, i cili kërkon që ish-gjyqtarët të kenë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet. Komisioni ka arritur në këtë përfundim pasi ka konsideruar se:

35.1. Llogaritja e afatit të ushtrimit të detyrës të z. Besnik Maho fillon nga data 03.10.2005, kur është emëruar/caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me Dekretin nr. 4655, datë 3.10.2005, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pas përfundimit të periudhës së stazhit profesional. Sipas Komisionit, z. Besnik Maho ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pasi është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec në datën 3.10.2005 e deri në datën 19.6.2007, kur ka kërkuar nga KLD-ja dorëheqjen nga funksioni i gjyqtarit dhe, duke llogaritur këtë periudhë kohore rezulton se z. Maho ka punuar në pozicionin e gjyqtarit për një periudhë prej 1 viti, 8 muaj dhe 16 ditësh.

35.2. Për sa i përket periudhës së kryerjes së stazhit profesional, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se, referuar dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur z. Besnik Maho ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, në dispozitat e ligjit nr. 8136/1996, "Për Shkollën e

---

<sup>9</sup> Ankuesi ka paraqitur në Komision shkresën zyrtare nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2021, të shtetasit Sh. K., me detyrë drejtor i filialit të Postës ShA., Tiranë, në të cilën bëhet me dije se dokumenti me bar kod nr. {\*\*\*} është depozituar në degën postare Tiranë, në datën 30.01.2017 dhe është dorëzuar në destinacion në datën 01.02.2017.

Magjistraturës”, i ndryshuar, parashikohet se individët që ndjekin studimet në këtë shkollë janë të titulluar si “kandidatë për magjistratë”, duke filluar nga përmbajtja e nenit 1 dhe deri në nenin 21 të tij. Në nenin 22, në të cilin parashikohet sanksioni për magjistratët e emëruar të cilët nuk pranojnë të ushtrojnë funksionet në vendin e emërimit, ligji ndryshon terminologjinë për kualifikimin e tyre nga “kandidatë për magjistratë” në “magjistratë”. Kjo dispozitë e ligjit e lidh fitimin e këtij titulli me emërimin e tyre, duke bërë një dallim të qartë mes statusit të tyre si “kandidatë për magjistratë” deri në fund të stazhit profesional dhe, në “magjistratë” vetëm pas emërimit që kryhet pas mbarimit të këtij stazhi, në përfundim të studimeve të plota në këtë shkollë.

**35.3.** Për sa i përket periudhës së punësimit si Drejtor i Përgjithshëm i AKKP-së, Komisioni ka interpretuar në vendim se ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikonte se gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve dhe pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbenin për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët ktheheshin në vendin e mëparshëm të punës dhe periudha e shërbimit njihej si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Gjithashtu, ky ligj parashikonte se periudha e shërbimit njihej si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kishin shërbyer në institucionet e mësipërme para hyrjes në fuqi të këtij ligji<sup>10</sup>, duke pasur fuqi prapavepruese. Në analizë të parashikimeve ligjore, konstatohet se gjyqtarët mund të shërbenin për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, pedagogë ose drejtorë në Shkollën e Magjistraturës etj., duke ruajtur statusin e tyre. Në këtë kuptim, ekzistonte një ndarje ndërmjet statusit të gjyqtarit dhe detyrës së tij, në kushtet kur gjyqtari e ruante statusin dhe kur ushtronte detyra të tjera jashtë pushtetit gjyqësor<sup>11</sup>.

**35.4.** Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet se: (i) z. Besnik Maho nuk e ka emrin në listat e përcjella nga organi kompetent, ish-KLD-ja; (ii) Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional i KLGj-së konfirmon se z. Maho nuk e ka statusin e magjistratit – ka vlerësuar se, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, në vitin 2016, kërkuesi Besnik Maho nuk e ka pasur statusin e magjistratit për shkak se pas shkarkimit të tij nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së nuk ka paraqitur kërkesë pranë KLD-së për t’u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës si gjyqtar, duke e humbur statusin e magjistratit për shkak të ligjit, (*ex lege*). Sipas Komisionit, edhe në një arsyetim ndryshe, nëse për efekt të llogaritjes do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit se duhet të përfshihet edhe periudha 19.06.2007 – 21.05.2008, përsëri nuk plotësohet afati 3-vjeçar në pozicionin e gjyqtarit.

---

<sup>10</sup> Ligji nr. 9877/2008, neni 28, parashikon: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjorë ose këshilltarë të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokurorë, pedagogë ose drejtorë në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës [...].

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe karrierës profesionale. 4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

<sup>11</sup> Paragrafët 67 dhe 68 të vendimit të Komisionit.

36. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimi, sipas përkufizimit të parashikuar në pikën 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është në rrethin e personave të përfshirë në pikën 4, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës, duke qenë se nuk plotëson në mënyrë kumulative kriteret për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk ka punuar të paktën 3 vjet në pozicionin e gjyqtarit.
37. Në analizë të situatës faktike që rezulton nga aktet e çështjes, të legjislacionit të zbatueshëm të kohës, të pretendimeve të paraqitura nga Komisioneri Publik dhe ankuesi Besnik Maho, si dhe të arsytimit të Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi, trupi gjykues analizon si vijon.
38. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore që përcaktojnë kthimin në sistem të ish-gjyqtarëve dhe ish-prokurorëve, duke iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, janë neni 179/b i Kushtetutës dhe neni 166 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës [...] *procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët [...] të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet [...].* Ndërsa, sipas nenit 166, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, *kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e rivlerësimit personat, të cilët janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet ose personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit [...].* Ndërkohë, në vijim të parashikimit të dispozitave kushtetuese, në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se [...] *subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës.*
39. Sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të mësipërme, që një ish-gjyqtar të rikthehet në sistemin e drejtësisë, duke iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, ai duhet të plotësojë kushtet: *(i) të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe të ketë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet; ose (ii) të ketë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit.*
40. Në rastin e ankuesit Besnik Maho, rezulton e provuar se ai ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002-2005 dhe, për rrjedhojë, përfshihet në kategorinë e ish-gjyqtarëve që duhet të plotësojnë dhe kushtin e ushtrimit të funksionit si magjistrat/gjyqtar të paktën për tre vjet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar.
41. Për sa i përket përcaktimit të periudhës së ushtrimit të detyrës si magjistrat, në rastin konkret konstatohet se ankuesi Besnik Maho ka kryer studimet dhe është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2002 - 2005. Me Dekretin nr. 4326, datë 17.09.2004, të Presidentit të Republikës, ankuesi është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndërsa me dekretin nr. 4655, datë 03.10.2005, të Presidentit të Republikës, ai është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në datën 13.6.2007, ankuesi ka paraqitur pranë ish-KLD-së kërkesën për t'u dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit dhe miratimin e kërkesës për t'u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. KLD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirin nga detyra të gjyqtarit. Sipas VKM-së nr. 392, datë 28.06.2007, “Për lirim dhe emërim në detyrë”, z. Besnik Maho është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë

së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe me VKM-në nr. 627, datë 21.05.2008, ai është shkarkuar nga kjo detyrë.

42. Në analizë të të dhënave të mësipërme, trupi gjykues vëren se periudha për të cilën diskutohet nëse ankuesi ka ushtruar funksionin e gjyqtarit është periudha nga data 17.09.2004, në të cilën ai ka filluar stazhin profesional si gjyqtar dhe deri në datën 21.05.2008, kur është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Kjo pasi, për periudhën më pas, angazhimi profesional që ka pasur ankuesi nuk përshtatet me ushtrimin e funksionit si gjyqtar.
43. Trupi gjykues vëren se, lidhur me llogaritjen e periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar, diskutimi që bëhet në rastin konkret, nisur nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, është nëse periudha e stazhit profesional dhe periudha e ushtrimit të funksionit si Drejtor i Përgjithshëm i AKKP-së nga ankuesi Besnik Maho do të konsiderohen si periudha të ushtrimit të funksionit si magjistrat/gjyqtar.
44. Komisioni nuk e ka konsideruar stazhin profesional si periudhë të ushtrimit të detyrës si gjyqtar, duke vlerësuar se në dispozitat e ligjit nr. 8136/1996 “Për Shkollën e Magjistraturës” ka një dallim të qartë mes statusit si “kandidat për magjistrat”, deri në fund të stazhit profesional dhe në “magjistrat”, vetëm pas emërimit që kryhet pas mbarimit të këtij stazhi, në përfundim të studimeve të plota në këtë shkollë. Këtë konkluzion të Komisionit e kundërshtojnë Komisioneri Publik dhe ankuesi Besnik Maho, të cilët argumentojnë se përlllogaritja e vjetërsisë në funksion si gjyqtar duhet të fillojë nga data 17.09.2004, kur ankuesi ka filluar stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
45. Në vlerësim të sa parashtruar më sipër, trupi gjykues vëren se ligji nr. 8136/1996 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, në kohën kur ankuesi Besnik Maho kryente stazhin profesional, në nenin 21<sup>12</sup> parashikonte se: *Gjatë periudhës së stazhit profesional kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njëjloj si magjistratët.* Sipas këtij parashikimi ligjor, kandidatët për magjistratë kishin të njëjtat detyrime si magjistratët që ishin në detyrë, dhe duke konsideruar se detyrimi kryesor për një magjistrat në detyrë është ushtrimi i funksionit, rrjedhimisht dhe kandidatët për magjistratë, gjatë kryerjes së stazhit profesional, kanë qenë në ushtrim të këtij funksioni. Ky fakt evidentohet nga kryerja nga kandidati për magjistrat i detyrave të njëjta si gjyqtarët e tjerë, pasi ai përfshihet në short dhe gjykon çështje njësoj si ata. Nga aktet që ka paraqitur ankuesi Besnik Maho, në KLD bashkë me formularin e vetëvlerësimit profesional, rezulton se gjatë periudhës së stazhit profesional prej gati një viti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ai ka gjykuar si gjyqtar 83 çështje civile, ka dhënë 25 urdhra ekzekutimi, ka gjykuar 23 çështje penale, si dhe ka dhënë 19 vendime për masa sigurimi, të dhëna këto që tregojnë për një ngarkesë pune të konsiderueshme si gjyqtar.
46. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se akti i Presidentit, Dekreti nr. 4326, datë 17.09.2004, titullohet “*Dekret për emërim gjyqtari*” dhe sipas përmbajtjes së tij “*Besnik Maho emërohet gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan*”. Me këtë akt, sipas nenit 20/a të ligjit nr. 8436/1998, kandidati për magjistrat konsiderohej i

---

<sup>12</sup> Sipas ndryshimit me ligjin nr. 9414, datë 20.05.2005.

emëruar si gjyqtar dhe dekreti i mëvonshëm i Presidentit, pas përfundimit të stazhit, vetëm përcaktonte gjykatën në të cilën ai do të vazhdonte ushtrimin e detyrës si gjyqtar.

47. Nga verifikimi i vendimeve të marra në vite nga KLGj-ja, në procedurat për verifikimin e plotësisimit nga kandidatët të kriterëve ligjore për ngritjen në detyrë, konstatohet se KLGj-ja, në vlerësimin dhe në verifikimin e përvojës profesionale të magistratëve, llogaritjen e vjetërsisë në ushtrimin e funksionit të magistratit e fillon nga data e nisjes së stazhit profesional në vitin e tretë të Shkollës së Magistraturës, duke e përfshirë dhe këtë periudhë në përvojën e punës dhe vjetërsinë si gjyqtar.
48. Konkretisht, KLGj-ja, në vendimin nr. 313, datë 06.06.2023, ka vlerësuar se [...] *kandidatja znj. {...} ka përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin 2016. Me dekret nr. 9326, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës, emërohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendim nr. 13, datë 10.02.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, caktohet në pozicion për të ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magistratit është 7 vite (deri në momentin e aplikimit të kandidatës në datën 01.12.2022, ajo rezulton të ketë 7 vjet e 10 ditë vjetërsi në funksion).*
49. I njëjti qëndrim është mbajtur nga KLGj-ja dhe në vendime të tjera të saj, në të cilat llogaritja e kriterit të vjetërsisë në ushtrimin e funksionit për magistratët gjyqtarë ka filluar nga momenti i nisjes së stazhit profesional në Shkollën e Magistraturës<sup>13</sup>. Në vendimet e KLGj-së konstatohet, gjithashtu, se në verifikimin në lidhje me përvojën specifike profesionale është marrë në konsideratë edhe përvoja mbi gjykimin e çështjeve në gjykatat ku kandidatët kanë kryer stazhin profesional, duke u specifikuar gjykimi i çështjeve me natyrë penale, civile apo familjare sipas rastit, si dhe numri i çështjeve përkatëse të gjykuara nga kandidati për magistrat.
50. Nga aktet e administruara nga Komisioni rezulton se të njëjtin vlerësim për përfshirjen e stazhit profesional në vjetërsinë në profesion duket të ketë bërë dhe KLD-ja në rastin e ankuesit Besnik Maho, referuar raportit nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2013, “Mbi rezultatet e kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në tabelën për vlerësimin e kandidatëve, pjesë e këtij raporti, rezulton se në kolonën për vjetërsinë në profesion për z. Besnik Maho është bërë shënimi: “3 vjet, 17.09.2004 stazh prf. Elbasan, 03.10.2005, Gjyqtar Pogradec, 19.06.2007, kërkesë për dorëheqje”.
51. Nga një verifikim i disa procesverbaleve të mbledhjeve të KLD-së, trupi gjykues konstaton se edhe ky organ ka përdorur të njëjtin vlerësim për përfshirjen e stazhit profesional si vjetërsi në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit. Konkretisht, sipas procesverbalit të mbledhjes së datës 29.04.2015, të KLD-së<sup>14</sup>, për dy nga kandidatët, Komisioni i Posaçëm për Shqyrtimin e

---

<sup>13</sup> Shih vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 312, datë 06.06.2023; nr. 311, datë 06.06.2023; nr. 310, datë 06.06.2023; nr. 511, datë 21.11.2022; nr. 15, datë 21.01.2021; nr. 629, datë 10.12.2020; nr. 246, datë 09.07.2020 dhe nr. 235, datë 02.07.2020; në <https://klgj.al/akte-administrative-individuale-2/>.

<sup>14</sup> <https://www.aksesdrejtesi.al/dokumenta/1575708582kld-2015-04-29.pdf>

Kandidatëve është shprehur se [...] Zonja K.M. ka ndjekur dhe përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe me dekretin nr. 4322, datë 17.09.2004, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare dhe është caktuar për kryerjen e stazhit profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me dekret të mëvonshëm të datës 03.10.2005 të Presidentit të Republikës është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe më pas është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me dekretin nr. 8643, datë 24.07.2014. Vjetërsia në punë si gjyqtare është 10 vjet, duke përfshirë këtu edhe vitin e stazhit profesional. [...] Kandidati S.I. gjatë viteve 2004-2007 ka ndjekur dhe përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe me dekretin nr. 5048, datë 04.10.2006, të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec [...]. Vjetërsia në punë si gjyqtar është 8 vjet, duke përfshirë këtu edhe periudhën e stazhit profesional.

52. Në konkluzion sa më sipër, trupi gjykues vëren se, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, ashtu dhe KLD-ja në periudhën e ushtrimit të veprimtarisë së saj, si organe kushtetuese përgjegjëse për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, bazuar në legjislacionin e kohës dhe në zbatim të tij, e kanë konsideruar periudhën e ushtrimit të stazhit profesional, vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, si periudhë gjatë së cilës kandidati ka ushtruar efektivisht funksionin e gjyqtarit, e cila llogaritet si periudhë vjetërsie në ushtrimin e këtij funksioni.
53. Në përfundim, në vlerësim të legjislacionit të zbatueshëm, si dhe të të dhënave faktike, trupi gjykues çmon se është i pabazuar qëndrimi i Komisionit, i cili duke interpretuar në mënyrë të ngushtë ligjin e kohës ka konkluduar se periudha e stazhit profesional e kryer nga kandidati për magjistrat nuk konsiderohet si ushtrim i detyrës së gjyqtarit dhe vjetërsi në profesion për efekt të karrierës profesionale.
54. Komisioneri Publik dhe ankuesi Besnik Maho kundërshtojnë dhe konkluzionin e Komisionit se periudha e ushtrimit të detyrës nga ankuesi si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nga data 28.06.2007 deri në datën 21.05.2008, në rastin e ankuesit nuk konsiderohet si periudhë që njihet në vjetërsinë e profesionit si gjyqtar. Trupi gjykues konstaton se arsyetimi i Komisionit për këtë konkluzion është i paqartë, i pasaktë dhe në interpretim të gabuar të dispozitës kushtetuese dhe ligjore, pasi në vendim Komisioni ka lidhur përjashtimin e kësaj periudhe me faktin se Besnik Maho, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, nuk ka qenë i emëruar dhe nuk ka ruajtur/pasur statusin e gjyqtarit<sup>15</sup>. Sipas Komisionit, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 2, shkronja “e”, parashikon se “i emëruar” është personi i cili është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe është emëruar si magjistrat nga Këshilli ose një ish-gjyqtar ose prokuror që është riemëruar nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion. Ndërsa, në nenin 39 të po këtij ligji, parashikohen kriteret për caktimin në pozicion të magjistratëve të emëruar. Sipas

---

<sup>15</sup> Komisioni referon në vendimin nr. 2/2020 të Kolegjit për SR Besnik Cani, por që rezulton se është për një situatë dhe interpretim ligjor të ndryshëm nga rasti në shqyrtim.



Komisionit, ligji e ndan konceptin e emërimit si *magjistrat* dhe *magjistratit në detyrë apo pozicion*.

55. Komisioni, në vlerësimin përfundimtar, pavarësisht nga mënyra se si ka arsytuar, nuk e ka konsideruar periudhën e ushtrimit të detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i AKKP-së si periudhë për efekt të vjetërsisë në detyrë të gjyqtarit. Ky konkluzion i Komisionit kundërshtohet, si nga Komisioneri Publik, ashtu dhe nga ankuesi Besnik Maho, i cili pretendon se në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, koha e shërbimit si funksionar i lartë në drejtimin e AKKP-së duhet të njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të karrierës profesionale.
56. Lidhur me sa paraqet dhe analizon Komisioni, trupi gjykues fillimisht vëren se ankuesi Besnik Maho ka paraqitur kërkesë, duke shprehur vullnetin për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, bazuar në parashikimet e pikës 4, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe jo si një gjyqtar që ka pasur statusin e magjistratit, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, siç është përpjekur ta trajtojë Komisioni.
57. Në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe të ankuesit, në analizë të legjislacionit në fuqi në periudhën në shqyrtim, trupi gjykues konstaton se ligji nr. 8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 4<sup>16</sup> parashikonte se: “3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. 4. Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë. Për vendet vakante në nivelet drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs. 5. Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë. 6. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, rëmërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs”.
58. Ligji nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30/a (shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000), parashikonte: “Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto struktura njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë. Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, rëmërohen gjyqtarë pa konkurs”.

---

<sup>16</sup> Pika 3 e këtij neni sipas ndryshimit me ligjin nr. 9112, datë 24.7.2003.

59. Ndërsa ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (i cili shfuqizoi ligjin nr. 8436/1998), në nenin 28 parashikonte: *“1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës. [...] 3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. 4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.*
60. Nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit<sup>17</sup> konstatohet se: (i) ankuesi Besnik Maho, i është drejtuar KLD-së në datën 13.06.2007 duke kërkuar dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, bazuar në nenin 27, pika 1 e ligjit nr. 8436/1998<sup>18</sup> dhe në nenin 4, pikat 3, 4, 5 dhe 6, të ligjit nr. 8678/2001, si dhe miratimin e kërkesës për t’u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë; (ii) Ministri i Drejtësisë, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2007, ka kërkuar nga KLD-ja dhënien e pëlqimit për kalimin e z. Besnik Maho me detyrë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sipas shkresës së Ministrit të Drejtësisë, [...] *duke qenë se z. Besnik Maho ushtron funksionin e gjyqtarit, në bazë të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 4 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e ministrisë së Drejtësisë”, angazhimi në nivelet drejtuese të strukturave të Ministrisë së Drejtësisë nuk e zhvesh gjyqtarin Besnik Maho nga statusi;* (iii) KLD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.06.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje të z. Besnik Maho dhe lirimin nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.
61. Nga aktet më sipër rezulton se ankuesi Besnik Maho, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi të kohës, ligjit nr. 8436/1998 dhe ligjit nr. 8678/2001, ka kërkuar të dorëhiqet nga funksioni i gjyqtarit për të ushtruar një detyrë tjetër, që, sipas dispozitave ligjore të kohës, njihej si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar dhe nuk sillte humbjen e statusit të gjyqtarit. Edhe pas ndryshimeve të mëvonshme ligjore, me miratimin e ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, gjatë kohës që ankuesi ka qenë duke ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, periudha e shërbimit në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë vazhdonte të njihej si periudhë vjetërsie si gjyqtar, edhe për ata gjyqtarë që kishin shërbyer para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
62. Trupi gjykues vëren se me të njëjtën qasje janë miratuar edhe ndryshimet e mëvonshme në ligjin nr. 8678/2001. Sipas ndryshimeve të nenit 4 të këtij ligji, me ligjin nr. 40/2017, datë 30.03.2017: *Magjistratët mund të komandohen në Ministrinë e Drejtësisë në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Magjistratët e komanduar gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.*

<sup>17</sup> Shkresa kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 22.05.2023, e KLGj-së dhe dokumentacioni shoqërues.

<sup>18</sup> Neni 27 parashikonte se: *“Gjyqtarët nuk mund të lëvizin nga detyra, përveç kur: 1. japin dorëheqjen; [...]”.*

63. Pavarësisht ndryshimeve në vite të legjislacionit që ka përcaktuar statusin e gjyqtarëve, ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë të qartë garancinë kushtetuese të paprekshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë të gjyqtarëve, parë nën dritën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila në disa vendime të saj rithekson se *karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138<sup>19</sup> i Kushtetutës. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë (shih vendimet nr. 31, datë 02.12.2009 dhe nr. 40, datë 07.07.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*
64. Në referim të dispozitave të mësipërme ligjore, trupi gjykues, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, arrin në konkluzionin se, sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm të kohës me ndryshimet përkatëse të interpretuar në mënyrë sistematike dhe harmonike, periudha që ankuesi Besnik Maho ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së duhet të konsiderohet si periudhë ushtrimi funksioni dhe vjetërsie në punë si gjyqtar. Pavarësisht se ankuesi pas shkarkimit nga detyra si drejtor AKKP-së nuk ka bërë kërkesë brenda afateve ligjore për t'u kthyer në sistem<sup>20</sup>, mosveprim që ka rezultuar me humbjen e statusit si gjyqtar, ky fakt nuk e ka cenuar vlefshmërinë e periudhës së ushtrimit të detyrës si funksionar i Ministrisë së Drejtësisë, për efekt të vjetërsisë në profesion, e cila konsiderohet e njëjtë me atë të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.
65. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi kërkimet e paraqitura nga Komisioneri Publik dhe ankuesi Besnik Maho në ankim dhe në parashtrime, kuadrin ligjor të zbatueshëm të kohës, si dhe të dhënat e akteve në fashikullin e Komisionit, vlerëson se, për efekt të procesit të rivlerësimit, përllogaritja e vjetërsisë në detyrë si gjyqtar, në rastin e ankuesit Besnik Maho, duhet të fillojë nga data 17.09.2004, kur me dekretin nr. 4326, të Presidentit, është emëruar dhe ka nisur stazhin profesional të Shkollës së Magjistraturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan e të shtrihet deri në datën 21.05.2008, kur është larguar nga detyra si funksionar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Kjo periudhë vjetërsie është 3 vjet, 8 muaj e katër ditë, pra, më shumë se kriteri trevjeçar i parashikuar në pikën 4, të nenit

<sup>19</sup> Neni 138 i Kushtetutës para ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016, parashikonte: “Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen”.

<sup>20</sup> Sipas nenit 28 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”: “1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës”. Në zbatim të këtij parashikimi, në rastin e ankuesit, ky afat 3-vjeçar fillonte nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9877, që ishte data 15 mars 2008 (ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 29.02.2008) dhe me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me AKKP-në, ankuesi duhet të kishte bërë menjëherë kërkesë në KLD për kthimin në funksionin e gjyqtarit.

179/b të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se ankuesi Besnik Maho përmbush kriterin ligjor të vjetërsisë të paktën 3 vjet të ushtrimit të detyrës si gjyqtar dhe, bazuar në parashikimet e pikës 4, të nenit 179/b të Kushtetutës dhe pikës 16, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, sipas kërkesës së tij, duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtar.

66. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues e gjen të bazuar në fakte dhe në ligj ankimin e Komisionerit Publik dhe ankimin e ankuesit Besnik Maho, dhe, për rrjedhojë, vlerëson se vendimi nr. 714, datë 15.11.2023, i Komisionit duhet të priset.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Prishjen e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë procesin e rivlerësimit kalimtar për kërkuesin Besnik Maho, ish-gjyqtar.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 13.05.2024, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*